


KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më **22/01/2021** hartohet dhe nënshkruhet kjo kontratë nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSI: GJERGJI RAMKU, i biri i Avniut, lindur në Tiranë më 30/06/1986, dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga_ "Kongresi i Manastirit", Pall 235/1 Ap 11, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim me nr.034714549 dhe nr personal I60630063S

BLERËSI: XHIMI BEGEJA, i biri i Hakiut, lindur në Tiranë , më 01/04/1964, dhe banues në Rruga e Dibrës Nr.124, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim me Nr.034764612 dhe Nr Personal G50401203S.

- A. Shoqëria "ABER ENGINEERING" shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar , regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NUIS L82030025U. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë:
- Projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim software. Shitje license software dhe shërbimet përkatëse që lidhen me to. Dhënie me qera e software. Software si shërbim. Shërbime të përshtatjes së softwarë. Shërbime të konsulencës në fushën e teknologjisë së informacionit. Shërbime trajnimi dhe edukimi në fushën teknologjisë së informacionit. Shërbime të menaxhimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit. Shitje, përpunim adeziv për xhama. Import-Eksport me shumicë dhe pakocë të materialeve të ndryshme në lidhje me këtë veprimtari.
- B. Shoqëria zotëron të gjitha licensat, autorizimet dhe lejet përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente shqiptare për të zhvilluar objektin e saj të veprimtarisë.
- C. Shitësi është ortak i shoqërisë "ABER ENGINEERING" shpk, duke zotëruar 50(pesëdhjetë) % të kapitalit.
- D. Shitësi dëshiron ti shesë Blerësit **50 kuota dmth 50 %** të kapitalit që zotëron në shoqërinë "ABER ENGINEERING" shpk.



- E. Blerësi: z. Xhimi Begeja është i interesuar të bleje 50 kuota dmth 50 % te kapitalit që Shitësi zotëron në kapitalin e shoqërisë “**ABER ENGINEERING**” shpk
- F. Në përputhje me nenin 73 “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave” shkronja b, pika 1, te ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” (i ndryshuar), nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kjo kontrate e shitjes së kuotave me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Shitja dhe Blerja e Kuotave

Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit **z.Xhimi Begeja** titullin e pronësisë, të parënduar me barrë, të **50 kuota dmth 50 % te kapitalit** që zotëron në kapitalin e shoqërisë “**ABER ENGINEERING**” shpk

Të gjitha të drejtat e lidhura me kuotat në fjalë ndjekin kuotat dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësave.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Kuotat


- 1.1 Blerësat do të bëhen zotërues me të drejta të plota i kuotave të blera në kapitalin e shoqërisë “**ABER ENGINEERING**” shpk, menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2

Çmimi dhe Pagesa

Çmimi i plote i shitjes që Blerësi : **z.Xhimi Begeja** do t’i paguajë Shitësit për shitjen e Kuotave është i barabartë me **50 lek**. Çmimi i shitjes do të paguhet nga Blerësi me lekë në dorë.

- 2.1 Në Datën e Nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi **z.Xhimi Begeja** do të jete pronari me të drejta të plota i **50 kuota dmth 50% te kapitalit** te blere .
- 2.2 Kalimi i Kuotave nga Shitësi tek Blerësi dhe çdo dokument shoqërues do të regjistrohen nga administratori i Shoqërisë ose nga i autorizuari i tij në Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.





Neni 3**Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**

Shitësi deklaron dhe garanton se:

3.1 Statusi i Shoqërisë

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 30/08/2018 me numër unik identifikimi NUIS L82030025U. Shoqëria është e organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit apo likuidimit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

3.2 Kuotat e parënduara me Barrë

Kuotat përfaqësojnë 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, janë të lira nga çdo Barrë dhe nuk ka asnjë marrëveshje, për të krijuar apo rënduar me Barrë asnjë nga Kuotat.

3.3 Pronari i ligjshëm

Shitësi deklaron dhe garanton se ai është pronari i ligjshëm i kuotave që shiten dhe gëzon të drejtën të lidhë këtë Kontratë dhe t'i kalojë Blerësit Kuotat objekt të kësaj Kontrate.

3.4 Përputhshmëria me ligjin

Shoqëria kryen dhe ka kryer aktivitet tregtar, nga data e themelimit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 4**TË NDRYSHME**

- 4.1 Amendamentet: Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje me shkrim të të dyja palëve.
- 4.2 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zevendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.
- 4.3 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 4.4 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 4.5 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje për secilën palë dhe një kopje për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Palët pasi lexuan këtë Kontratë dhe janë dakort me përmbajtjen e saj, me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë nënshkruajnë si më poshtë.

PALËT

SHITËSI

Gjergji Ramku

Gjergji Ramku
[Signature]

BLERËSI

Xhimi Begeja

Xhimi Begeja
[Signature]

